

FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë)

TRIMED

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

K51612031J

NUIS/NIPT

Autostrada Tirane -Durres , Km 10, Zone Kadastrale 2105, Nr.Pasurie 95/11.

Adresa

Tiranë

Albania

1050

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

0689083999

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

finance@trimed.com.al

E-mail

Administrator Gentiana Peshkatari

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

2023/10/27

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

+355692092330

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.

REF-84207-10-18-2023

Tipi i procedurës për ankesën

Procedure Prokurimi Publik

Tipi i ankesës

Dokumenta Tenderi

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open INT

Autoriteti/Enti Kontraktor

Emri i autoritetit/entit kontraktor që administrojnë procesin e prokurimit.

Spitali Rajonal “Memorial” Fier

Vlera e përllogaritur e prokurimit

Vlera e përllogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)

65870925

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.

“Blerje materiale për diagnostikimin e DSA Cerebrale dhe Trombektomi ”

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

Data (viti/muaji/dita)

2023/11/24

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)

Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës)

Tipi i kontratës

Data e zhvillimit të procedurës

Mallra

2023/11/24

Numri i njoftimit

Kodi CPV

CN/88129/10182023

33140000-3

Ankese mbi argument në KPP

Seksioni III: Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

Ligjin Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe me VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate

(Citoni kontratën për të cilën kërkoni pavlefshmërinë)

- Tjetër

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

3. Rrethanat dhe faktet □

Përshkruani rrethanat e faktit. □

Të nderuar zotërinj!

Operatori ekonomik “TRIMED” sh.p.k këtu e më poshtë “OE”, përmes sistemit të prokurimit elektronik ka marrë djeni për zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje materiale për diagnostikimin e DSA Cerebrale dhe Trombektomi”, me autoritet kontraktor Spitali Rajonal Memorial Fier, procedurë e cila do të zhvillohet në datën 24.11.2023.

Në lidhje me kriteret e përcaktuara në DST shohim se disa prej tyre vijnë në kundërshtim me Ligjin Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe me VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.

Në DST është përcaktuar se kjo është një procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar. Si e tillë, kjo lloj procedure jep akses për të konkuruar edhe kompani të huaja të cilat kanë interes. Për këtë arsye dokumentacioni i kërkuar nga Autoriteti Kontraktor duhet të pranohet në gjuhën shqip ose anglisht. Por kjo nuk reflektohet në pikat e DST pasi konkretisht:

Kriteri 2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vetëdeklarim se të gjitha materialet nga ofertuesi janë konform Direktivave dhe klasifikimit të Këshillit të Europës, bashkëlidhur me kopjet e certifikatave përkatëse CE/DC (Deklarate konformiteti) ose FDA, origjinale ose fotokopje të perkthyer dhe të noterizuara të vlefshme në momentin e dorëzimit të ofertave (kur është e aplikueshme).

Kriteri 2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim të leshuar nga firma prodhuese ose distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi /MAH/ për Shqipërinë (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin), nëpërmjet të cilit konfirmohet se autorizohet të tregtoje materialet mjekësore objekt prokurimi. Autorizimi duhet të jete i vlefshëm në momentin e hapjes dhe dorëzimit të ofertave; dhe origjinale ose fotokopje të perkthyer dhe të noterizuara.

Kriteri 2.3.7 Për të gjithë artikujt e ofruar të paraqiten Katalogje, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull (pjesët e katalogut që përmbajnë emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohe, nese nuk janë në gjuhën shqipe, të perkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen). Operatori ekonomik duhet të markoje në katalogun përkatës produktet që ofron sipas numrit rendor (të markuara sipas artikullit) të përcaktuar në formularin e ofertes. Katalogjet do pranohen vetëm në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit.

Siç shihet sa më sipër, Autoriteti Kontraktor ka diskriminuar dhe ka kufizuar procedurën për kompanitë pjesëmarrëse në të, në kundërshtim me përcaktimet ligjore.

Në nenin 24 të VKM Nr.285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pika 2, përcaktohet: “Në rastin e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë,

dokumentet e tenderit duhet të hartohen në gjuhët shqip dhe anglisht. Operatorët ekonomikë mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht.

Pra shihet qartë që ligji përcakton se nuk duhet të kufizohet gjuha e pjesëmarrjes në procedurë duke vendosur si kusht përkthimin dhe noterizimin në gjuhën shqip.

Sa më sipar, në zbatim të ligjit kërkojmë që të ndryshohet ky kriter duke vendosur edhe gjuhën angleze si alternativë, në përputhje me përcaktimet ligjore.

Në DST, Autoriteti Kontraktor ka vendosur si kriter paraqitjen e mostrave dhe konkretisht ka përcaktuar:

Kriteri 2.3.9 Për artikujt e mëposhtëm duhet te paraqiten mostra ditën e hapjes se ofertave, me date 24.11.2023 ne oren 09:00.

Lista e Mostrave:

- | Nr. | Pershkrimi |
|-----|--|
| 2 | Angiographic Vertebral Catheter 5 fr, length 100 cm |
| 5 | Angiographic Simmons 2 Catheter, 5 fr, length 100 cm |
| 7 | Angiographic aorto and vena cava Catheter, 5Fr pigtail, length 65-90cm. |
| 8 | Hydrophilic angeled guideëire standard, 0.035 , length 150-180 cm |
| 14 | Femoral Introducer set 6 Fr, 10-11 cm |
| 18 | Mainfold, 3-port OFF version rotating adapter male right, resistant up to 35 bar (500 psi), transparent housing for visual control, steril. (Manifold me 3-porta modeli OFF me pershtates rrotullues mashkull te djathte, rezistent deri në 35 bar (500 psi), trup transparente për kontrollin vizual, steril). |
| 20 | Stent Karotid me vetezgjerim ne forme konike per pershtatje ne enet karotide te bifurkuara, me markues radiopak ne kateter si dhe markues tantali ne skajet e stentit per vizualizim dhe pozicionim te sakte, kateter me gjatesi 135cm, diameter per stentat kinike 10x7mm me gjatesi stente 30cm dhe 40cm, sheath i rekomanduar 6F. Profil kalueshmerie 0.078inch, guideëire i rekomanduar 0.014inch. |
| 25 | Rrjete e thurur nitinoli per mbrojtje cerebrale me markues gold / tungsten, kompatibel me guideëire 0.014 dhe 0.018 . Permasa e rrjetes 5mm, gjatesia e fijos 320cm. |
| 31 | Guideëire 0.035", prej nitinoli, shaft fleksibel, gjatësi 180 – 185 cm, majë më të drejtë, me gjatësi maje 14-15 cm |
| 33 | 150 ml Syringe Medrad Mark 7 or equivalent |
| 41 | Shiringë e njeperdorimeshee për lidhje me kolektorë dhe kateterë, për injektim me dorë të kontrastit, heparinës, solucionit të kripur dhe lëngjeve të tjera, prej material polikarbonati për të siguruar vizualizimin e lehtë të niveleve të lëngut dhe injektim të saktë, I.D 0,100 inç. 10 ml blu). |
| 42 | Pajisje fryrese 30atm, ventil 3-rrugesh, pershtates-Y, age metalike per futjen e e guides dhe torqu. |
| 45 | Pressure Infusion Bag, 500 - 3000 ml ëith manometer |
| 47 | PTA Balloon Catheter - Balon Kateter PTA me diameter 5-6mm dhe me gjatesi 20-30mm |
| 48 | Sheath Introducer Femoral 8Fr 11-25cm |
| 50 | Kateter Guiding 8F JR4 |
| 54 | Pajisje per heqje trombi, stent me diameter 4mm dhe gjatesi 40mm, gjatesi totale e stentit 50-52mm, e pershtatshme per ene gjaku me diameter 2.0 deri ne 4.0mm, kompatible me mikrokateter 0.021 -0.027 , gjatesi e telit 200-205cm, te pakten tre markues distal dhe nje proksimal si dhe markues gjate trupit te stentit per vizualizim gjate nderhyrhjes. |
| 59 | Mikrokateter me gjatesi pune 150-160cm dhe me diameter te brendshem 0.017-0.027inch, me maje te drejte, me sgment te bute distal 6cm. |

Dorëzimi i kampioneve/ mostrave, të bëhet pranë zyrës së protokollit , te mbyllura në një zarf /kuti jo transparente të vëlosur mbi të cilin të shenohet:

? “Mos e hapni me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit të Ofertave për këtë procedurë prokurimi dhe jo para datës 24.11.2023 në orën 09:00.

? Se bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkresë të vëlosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti.

? Mbi çdo mostër të dorëzuar, ofertuesi duhet të shënojë Nr.Renditor të Artikullit që përfaqëson.

Nëse mostrat e dorëzuara, nuk janë të shoqëruara me listën e inventarizimit dhe të identifikuar sipas Nr. Renditor, nëse ka mungesa mostrash për artikuj të veçantë, atëherë oferta do të quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do të skualifikohet.

Sërish edhe këtu jemi përballë vendosjes së kriterit diskriminues dhe kufizues për garën nga ana e Autoritetit Kontraktor në kundërshtim me përcaktimet ligjore dhe me praktikën e konsoliduar të KPP.

Në nenin 40 të VKM Nr.285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pika 6, përcaktohet: Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

- a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose
- b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose
- c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

Siç shihet më sipër, ligji e kristalizon shumë qartë procesin e vendosjes së një kriteri për paraqitjen e mostrave dhe e le në formë alternative. Autoriteti Kontraktor në këtë rast i ka kërkuar të treja përcaktimet që parashikon ligji, në formën e kritereve të veçanta, ku përveç mostrave, ka kërkuar edhe katalogë, edhe çertifikata CE/DC/FDA, konkretisht si më poshtë:

Kriteri 2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vetëdeklarim se të gjitha materialet nga ofertuesi janë konform Direktivave dhe klasifikimit të Këshillit të Europës, bashkëlidhur me kopjet e certifikatave përkatëse CE/DC (Deklarate konformiteti) ose FDA, origjinale ose fotokopje të perkthyer dhe të noterizuara të vlefshme në momentin e dorëzimit të ofertave (kur është e aplikueshme).

Kriteri 2.3.7 Për të gjithë artikujt e ofruar të paraqiten Katalogje, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull (pjesët e katalogut që përmbajnë emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohet, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të perkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron sipas numrit renditor (të markuara sipas artikullit) të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogjet do pranohen vetëm në formë elektronike nëpërmjet

sistemit elektronik te prokurimit.

Duke qenë se jemi përpara një procedure të hapur mbi kufirin e lartë monetar, ku potencialisht ftohen të konkurojnë edhe kompani nga jashtë vendit, ky kriter jo vetëm që paraqitet diskriminues dhe i pajustificuar, por edhe e kufizon në maksimum procedurën nga ana e Autoritetit Kontraktor.

Në pikën 1 të Udhëzimit të Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 03, datë 12.04.2022 “Mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomikë” përcaktohet se:

“Autoriteti/Enti kontraktor, mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë mostra të mallit, objekt prokurimi, kur gjykon se është e rëndësishme për vlerësimin e aspektit teknik të ofertës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë teknikisht vendosjen e kriterit për kualifikim për paraqitjen e mostrave, dhe ky argumentim duhet të pasqyrohet në procesverbalin e argumentimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta të pranimit, i cili publikohet së bashku me dokumentet e tenderit në Sistemin e Prokurimit Publik (në vijim “SPE”).”.

Në procesverbalin datë 18.10.2023 “PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM” të publikuar në sistemin elektronik të prokurimit, autoriteti kontraktor ka argumentuar vendosjen e këtij kriteri kualifikues objekt-ankimi si në vijim:

Kriteri 2.3.9 Për artikujt e mëposhtëm duhet te paraqiten mostra ditën e hapjes se ofertave, me date 24.11.2023 ne oren 09:00.

Lista e Mostrave:

- | Nr. | Pershkrimi |
|-----|--|
| 2 | Angiographic Vertebral Catheter 5 fr, length 100 cm |
| 5 | Angiographic Simmons 2 Catheter, 5 fr, length 100 cm |
| 7 | Angiographic aorto and vena cava Catheter, 5Fr pigtail, length 65-90cm. |
| 8 | Hydrophilic angeled guideëire standard, 0.035 , length 150-180 cm |
| 14 | Femoral Introducer set 6 Fr, 10-11 cm |
| 18 | Mainfold, 3-port OFF version rotating adapter male right, resistant up to 35 bar (500 psi), transparent housing for visual control, steril. (Manifold me 3-porta modeli OFF me pershtates rrotullues mashkull te djathte, rezistent deri në 35 bar (500 psi), trup transparente për kontrollin vizual, steril). |
| 20 | Stent Karotid me vetezgjerim ne forme konike per pershtatje ne enet karotide te bifurkuara, me markues radiopak ne kateter si dhe markues tantali ne skajet e stentit per vizualizim dhe pozicionim te sakte, kateter me gjatesi 135cm, diameter per stentat kinike 10x7mm me gjatesi stente 30cm dhe 40cm, sheath i rekomanduar 6F. Profil kalueshmerie 0.078inch, guideëire i rekomanduar 0.014inch. |
| 25 | Rrjete e thurur nitinoli per mbrojtje cerebrale me markues gold / tungsten, kompatibel me guideëire 0.014 dhe 0.018 . Permasa e rrjetes 5mm, gjatesia e fijos 320cm. |
| 31 | Guideëire 0.035”, prej nitinoli, shaft fleksibel, gjatësi 180 – 185 cm, majë më të drejtë, me gjatësi maje 14-15 cm |
| 33 | 150 ml Syringe Medrad Mark 7 or equivalent |
| 41 | Shiringë e njeperdorimeshee për lidhje me kolektorë dhe kateterë, për injektim me dorë të kontrastit, heparinës, solucionit të kripur dhe lëngjeve të tjera, prej material polikarbonati për të siguruar vizualizimin e lehtë të niveleve të lëngut dhe injektim të saktë, I.D 0,100 inç. 10 ml blu). |
| 42 | Pajisje fryrese 30atm, ventil 3-rrugesh, pershtates-Y, age metalike per futjen e e guides dhe torqu. |
| 45 | Pressure Infusion Bag, 500 - 3000 ml ëith manometer |
| 47 | PTA Balloon Catheter - Balon Kateter PTA me diameter 5-6mm dhe me gjatesi |

20-30mm

48 Sheath Introducer Femoral 8Fr 11-25cm

50 Kateter Guiding 8F JR4

54 Pajisje per heqje trombi, stent me diameter 4mm dhe gjatesi 40mm, gjatesi totale e stentit 50-52mm, e pershtatshme per ene gjaku me diameter 2.0 deri ne 4.0mm, kompatible me mikrokateter 0.021 -0.027 , gjatesi e telit 200-205cm, te pakten tre markues distal dhe nje proksimal si dhe markues gjate trupit te stentit per vizualizim gjate nderhyrhjes.

59 Mikrokateter me gjatesi pune 150-160cm dhe me diameter te brendshem 0.017-0.027inch, me maje te drejte, me sgment te bute distal 6cm.

Dorëzimi i kampioneve/ mostrave, të bëhet prane zyrës së protokollit , te mbyllura ne nje zarf /kuti jo transparente te vulosur mbi te cilin te shenohet:

? “Mos e hapni me përjashtim te rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit te Ofertave për këtë procedurë prokurimi dhe jo para dates 24.11.2023 ne oren 09:00.

? Se bashku me mostrat ofertuesi duhet te japë edhe një shkresë te vulosur dhe firmosur ku te listohen mostrat qe ndodhen ne zarf/kuti.

? Mbi çdo mostër te dorëzuar, ofertuesi duhet te shënoje Nr.Rendor te Artikullit qe përfaqëson.

Nëse mostrat e dorëzuara, nuk janë te shoqëruara me listën e inventarizimit dhe të identifikuara sipas Nr. Rendor, nëse ka mungesa mostrash për artikuj te veçantë, atëherë oferta do te quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do te skualifikohet.

Argumentimi kriterin 2.3.9: Ky kriter është vendosur nga ana e Autoritetit Kontraktor me qëllim vërtetimin se operatori ekonomik i plotëson kërkesat minimale në përputhje me nenin 40, pika 6 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. ku shprehet rrjedhimisht: 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. N? k?t? rast, autoriteti/enti kontraktor duhet t? argumentoj? k?rkes?n p?r mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. N? rastin e procedurave t? zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor p?rfaqton qart? procedur?n p?r dor?zimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori t? interesuar si dhe konfidencialitetin p?r pjes?marrjen n? proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/oseParaqitja e mostrave i shërben autoritetit kontraktor për të gjykuar më mire mbi përmbushjen e specifikimeve teknike të kërkuara për objektet që prokurohen me qëllim që cilësia e mallit të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga AK. Shihet qartë, që Autoriteti Kontraktor në argumentimin e këtij kriteri nuk jep asnjë argument teknik se përse e ka vendosur, por vendos vetëm referencën ligjore, në kundërshtim me të gjitha dispozitat urdhëruese dhe udhëzuese.

Vetë KPP, në një rast analog konkretisht në Vendimin Nr.646/2022 ka mbajtur një qëndrim konform pretendimeve tona përse i përket kriterit për paraqitjen e mostrave në një procedurë prokurimi, duke bërë vendosur modifikimin dhe heqjen e tij. Kështu, KPP shprehet se: “III.2.6. Referuar dispozitave ligjore të sipërcituara, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet ekonomike, besueshmërinë, dhe përvojën e duhur, në përputhje dhe në përpjesëtim me volumin e kontratës objekt-prokurimi, për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur. Komisioni sjell në vëmendje të autoritetit kontraktor faktin, se duke qenë se fryma e Ligjit të Prokurimit Publik bazohet në këto parime: “mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve; transparencë në procedurat e prokurimit; barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve”, kriteret për kualifikim duhet të hartohen në mënyre të tillë që të jenë

gjithëpërfshirëse si dhe të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël e të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik. III.2.7. Komisioni i Prokurimit Publik, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, pretendimit të ankimuesit dhe informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, konstaton, se ky i fundit ka kërkuar kërkuar shprehimisht në kriteret e veçanta të kualifikimit, që operatorët ekonomikë duhet të paraqesin mostra për të gjithë artikujt objekt prokurimi. Nga verifikimi i dokumenteve të tenderit, procesverbalit datë 15.06.2022 “PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM” dhe referuar bazës ligjore të sipërpërmendur, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteri në lidhje me paraqitjen e mostrave për të gjithë artikujt objekt-prokurimi është sipas parashikimeve të nenit 40, pika 6/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, por nga ana e autoritetit kontraktor nuk është dhënë asnjë argument teknik, se përse kërkohet paraqitja e mostrave sikurse parashikohet në pikën 1 të Udhëzimit të Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 03, datë 12.04.2022, “Mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomikë” dhe për më tepër ky kriter është një kriter i dubluar dhe që krijon kosto të shtuara për operatorët ekonomikë, pasi në pikën 2.3.8 “Kapaciteti teknik” të Shtojcës 7 të dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor për të krijuar bindjen se produktet e ofruara nga operatorët ekonomik ofertues do të jenë sipas specifikimeve teknike të dhëna në dokumentet e tenderit, ka përcaktuar që këta ofertues të paraqesin katalogët teknikë për këto artikuj, ku të vërtetohet përputhshmëria e tyre me specifikimet teknike të publikuara, prandaj autoriteti kontraktor duhet të heqë kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.9 “Kapaciteti teknik” të Shtojcës 7 të dokumenteve të tenderit, pasi nuk e ka argumentuar nga ana teknike vendosjen e këtij kriteri. Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.”

Sërish KPP, në një tjetër rast analog mutatis mutandis konkretisht në Vendimin Nr.502/2023 ka mbajtur të njëjtin qëndrim përse i përket kriterit diskriminues dhe të paargumentuar teknikisht për paraqitjen e mostrave në një procedurë prokurimi, duke bërë vendosur modifikimin dhe heqjen e tij. Kështu, KPP shprehet se: III.1.11. Në lidhje me kundërshtimet e mësipërme të operatorëve ekonomikë ankimues, mbi modifikimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në faktin nëse kriteri i mësipërm është në proporcion me objektin e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 77 pika 1 të LPP-së. Në rastin konkret KPP konstaton, se synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi, se subjektet ofertues zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin e 22 kontratës. KPP konstaton, se për përmbushjen e këtij synimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm kriterë kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e kapacitetit teknik, por edhe kriterë të tjera kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e plotësisimit të specifikimeve teknike të produkteve. Nga shqyrtimi i artikujve objekt-prokurimi, si dhe specifikimeve teknike të tyre, të vendosura nga autoriteti kontraktor, KPP vëren, se për disa nga këto artikuj kërkohet të paraqiten kampione ditën e realizimit të tenderit. Konkretisht, artikujt e shënuar me shenjën (*) në shtojcën 5 dhe shtojcën 6 të dokumenteve të tenderit. Sa më sipër, referuar kërkesave të vendosura nga autoriteti kontraktor, si dhe argumenteve të parashtruara nga operatorët ekonomikë ankimues në ankesat e tyre, gjykojmë, se autoriteti kontraktor për artikujt objekt-ankimi ndër të tjera ka kërkuar paraqitjen e kampioneve si dhe katalogë të markuar, me qëllim verifikimin e përmbushjes së specifikimeve teknike. Referuar objektit të prokurimit, si dhe natyrës së produkteve që kërkohet të furnizohet, gjykojmë, se kërkesa e autoritetit kontraktor për paraqitjen e kampioneve të disa produkteve, sjell një kufizim të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi, duke qenë se autoriteti kontraktor me qëllim verifikimin e përmbushjes së specifikimeve teknike të produkteve ka kërkuar edhe paraqitjen e katalogëve, për secilin prej artikujve. Akoma më tej, për përmbushjen e specifikimeve teknike, konkretisht për sa i përket vërtetimit të kapacitetit të operatorëve ekonomikë për realizimin e këtyre produkteve sipas specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, ka parashikuar plotësimin e deklaratës në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës. Në

këto kushte, KPP gjykon, se kërkesa e mësipërme e autoritetit kontraktor mbi dorëzimin e kampioneve për disa nga artikujt, është një kërkesë e ekzagjeruar dhe shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit. Vlen të theksojmë, se qëllimi i autoritetit kontraktor, është furnizimi në kohë dhe në cilësi me produktet objekt-prokurimi, por në respekt të parimeve të ligjit për prokurimin publik, kriteret e kualifikimit të hartuara nga autoriteti kontraktor, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë /përfshijnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtarë apo ndërkombëtarë. Në hartimin e kriterëve të kualifikimit autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, e cila kufizon pjesëmarrjen e gjerë të operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi. Sa më sipër, Komisioni gjykon, se nisur nga natyra e produkteve objekt-prokurimi, është e mjaftueshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të vërtetojnë përmbushjen e specifikimeve teknike për këto artikuj, duke paraqitur katalogët e markuar me të dhënat teknike për secilin prej tyre.

Nën dritën e interpretimit të vendimeve të KPP, kërkojmë përmes kësaj ankese që AK ta modifikojë DST duke e hequr kriterin për paraqitjen e mostrave, duke hapur në këtë mënyrë garën për një pjesëmarrje të të gjithë operatorëve ekonomik shqiptarë dhe të huaj si dhe duke mos krijuar kosto të dubluar për pjesëmarrje në procedurë dhe as duke e komplikuar atë.

Sa më sipër, në zbatim të ligjit kërkojmë që të ndryshohet DST duke u hequr kriteri për paraqitjen e mostrave, në përputhje me përcaktimet ligjore dhe vendimet e KPP.

5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme

Po

Jo

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkonte)

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

Nuk ka

7. Lista e informacionit konfidencial:

I gjithë informacioni

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.

Kujdes: Ankimesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.**

Shënim: Ankimesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

Nr. i faksit:

E-mail:

finance@trimed.com.al

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit

Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar

Gentiana Peshkatari